



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 624 prot.

Fushë-Arrëz, më 28. 02. 2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, më 28.02.2025, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.

Në mbledhje marrin pjesë:

- **Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak;
- **Lezina Ceca**, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak;
- **Bardhok Qafa**, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak;
- Këshilltarët: **Besjana Marku; Franc Doda; Lin Prendi; Pavlin Qafa; Tereze Dema; Valentin Doçi ;**

**Vjollca Tabakaj; Zef Cara.**

( 11 këshilltarë nga 15 gjithsej)

Gjithashtu në mbledhje merr pjesë Kryetari i bashkisë, **Z. Hil Curri**

Nodohen në sallën e Këshillit Bashkiak **specialistët e Bashkisë** që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

Mbledhja kryesohet dhe hapet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku**:

Përvendetje të gjithëve! Mirë se keni ardhë në këtë maledhje të radhës të Këshillit Bashkiak për muajin Shkurt 2025! Në vijim të njofimit të fundit zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak. Verifikojmë pjesëmarrjen (11 këshilltarë) e cila plotëson kushtet për zhvillimin e mbledhjes.

Parashtrohet rendi i ditës:

1. Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 % për muajin Janar 2025.
2. Raport monitorimi i buxhetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën Shtator-Dhjetor 2024 ( progresiv).
3. Projektvendim për miratimin e propozimit për dhënie titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Fushë-Arrëz të Z. Ndoc Prendi.
4. Raport vjetor i veprimtarisë dhe vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, për periudhën Janar-Dhjetor 2024.
5. Rishqyrtimi i vendimeve të kthyera nga Prefektura.

6. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
7. Të ndryshme.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Atëherë ju ftoj të miratojmë rendin e ditës përmes votimit:

- Miratohet rendi i ditës me shumicë votash:

**11 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 1 e rendit të ditës:** Miratimi i projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Janar 2025. Atëherë të referojë zyra dhe komisioni përkatës.

**Sidorela Katroshi**, Drejtoreshë e Emigracionit e Çeshtjeve Sociale, shpjegon se për muajin Janar 2025 kemi propozuar për ndihme ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës i 6%, 32 familje, dhe fond **125,275** lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën **2,087,933** lekë dhe shpërndarë për përfituesit e **6%** në Shumën **120,390** lekë të shpërndarë sipas Njësive Administrative:

1. Bashkia Qendër Fushë-Arrëz , 17 familje me fond 61,487 lekë.
2. Njësia Qafë-Mali ,4 familje me fond 13,999 lekë .
3. Njësia Blerim , 4 familje me fond 18,016 lekë.
4. Njësia Fierzë , 2 familje me fond 6,752 lekë .
5. Njësia Iballë , 5 familje me fond 20,136 lekë .

Familjet që dalin nga sistemi për pikë të pamjaftueshme janë:

Rexhep Beqir Hasanaj (Qendër); Liljana Mark Doda (Qafë –Mali).

Shtohen në bllok-ndihmën prej 6% familjet:

Rexhep Beqir Hasanaj (familje e varfër pa asnjë të ardhur )

Largohet nga bllok-ndihma prej 6% familja:

Geg Mati Bibaj (Qafë – Mali) – është punësuar bashkëshortja.

Gjelosh Pal Marku ( Lagjia Memaj ) – për riaplikim në Ndihmë Ekonomike

**Franc Doda, anëtar i Komisionit të Mirëqenies Sociale** shprehet se komisioni janë dakord me propozimet e Zyrës së Çeshtjeve Sociale për familjet që përfitojnë 6% të bllok-ndihmës ekonomike sipas listave të sjella.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Duke qenë se ju komisioni keni rënë dakord i propozojmë Këshillit të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Janar 2025.

Atëherë ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Janar 2025 përmes votimit:

- Miratohet Projektvendimi për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Janar 2025 **me:**

**11 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Pika numër 2 e rendit të ditës:** Raport monitorimi i buxhetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën Shtator-Dhjetor 2024 (progresiv).

**Dritan Lika**, Përgjegjës i Zyrës së Financës:

Ky Raport i paraqitet Ministrisë së Financës çdo 4- mujor dhe Këshillit të bashkisë. Për këtë është respektuar kuadri ligjor për afatet kohore të paraqitjes.

Raporti përmban të ardhurat dhe shpenzimet e kryera në nivel programesh dhe në nivel artikujsh për buxhetin e bashkisë Fushë-Arrëz. Rikujtojmë se fondet që i kanë ardhë bashkisë Fushë-Arrëz janë:

Transferta e Pakushtëzuar, Transferta sektoriale, Transferta e kushtëzuar, Transferta të trashëgura, Të Ardhurat e Planifikuara për vitin dhe Të Ardhurat e Trashëgura. Kemi kaluar edhe dy raporte të tjera për dy 4-mujorët tjerë të mëparshëm për vitin 2024.

Këto transferta paraqiten edhe në mënyrë grafike. Duket qartë se Transferta Sektoriale zë peshën më të madhe të transfertave. Transferta e pakushtëzuar zë vetëm 24%, ndërsa të trashëgura nga viti i mëparshëm janë 24%. Të ardhurat e veta zënë vetëm 6% të buxhetit.

Tabela e realizimit të të ardhurave për vitin 2024 tregon qartë se ka patur një realizim mbi planifikimin, eshtë rreth 59% më shumë sesa planifikimi. Është viti më i mirë i realizimit të të ardhurave. Kjo vlerë mbi planifikimet lidhet me dy projektet që bashkia ka fituar me donatorë të huaj, eshtë një projekt me Ambasadën Japoneze me vlerë rreth 6.3 milion lekë të reja dhe një projekt me UNDP.

Projekti me Ambasadën Japoneze konsiston në blerjen e një mjeti tip fadromë për pëmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve rurale, ndërsa projekt me UNDP-në është projekt i karakterit social. Nga grafiku duket qartë se realizimi i të ardhurave është më lart sesa planifikimi.

Realizimi i të ardhurave është në masën 159.83% ku peshën më të madhe e zënë dy projektet që u përmendën por një peshë gjithashtu zë edhe tarifa e pastrimit dhe të ardhurat nga qiratë.

Në tabelën e shfaqur në monitor janë paraqitur të gjitha shpenzimet në planifikim, realizim dhe përqindje realizimi. Në total shpenzimet janë realizuar në masën 79%.

Në monitor paraqiten grafikisht shpenzimet. Duket qartë që pjësa më e madhe e shpenzimeve i përket çeshtjeve sociale siç është ndima ekonomike dhe paaftësia, përkujdesja. Më pas vijnë shpenzimet që lidhen me funksionet e transferuara, më pas vijnë shpenzimet e transferuara siç është administrimi i pyjeve, arsimi bazë etj, e në fund janë shpenzimet për të gjitha transfertat e tjera.

Shpenzimet janë paraqitur përvçese në nivel programesh edhe në nivel artikujsh. Në shpenzimet në nivel artikujsh investimet zënë rreth 24.5% të totalit të buxhetit, shpenzimet për pagat zënë 37.6%, për sigurimet shoqërore 6.3%, për shpenzime operative 10%, transfertat 41.2%.

Këto shpenzime janë paraqitur edhe në mënyrë grafike për të krijuar një ide më të qartë. Nga grafiku shpenzimet për pagat zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve në bashki.

Vëmendje e veçantë në raport i është kushtuar investimeve, kemi pasë rreth 40 objekte për investime të cilat jnë realizuar në masën 80%. Në disa objekte nuk është arritur të realizohen investimet prandaj janë transferuar për vitin 2025. Realizimi 80% është i kënaqshëm duke u krahasuar me vitet e mëparshme. Lista në tabelën e shfaqur në monitor është miratuar nga KB gjatë vitit 2024.

Duhet të theksohet fakti që bashkia Fushë-Arrëz nuk ka krijuar asnjë detyrim të prapambetur gjatë kësaj periudhe. Kjo ishte një panoramë e shkurtër lidhur me Raportin e monitorimit për vitin 2024.

Të dhënat nga Raporti janë shfaqur në monitor ku ndiqen nga të gjithë të pranishmit përmes shpjegimeve të dhëna nga **Dritan Lika**, Përgjegjës i Zyrës së Financës.

#### **Vjollca Tabakaj, anëtare e këshillit të bashkisë:**

Gjatë shpjegimit u vu re që pagat kanë një vlerë më të madhe se investimet dhe kjo, mua nuk po më duket normale, pavarësisht se nuk jam specialist ekonomie.

#### **Dritan Lika, Përgjegjës i Zyrës së Financës:**

Kjo është një bashki si gjitha të tjera që miraton në këshill edhe numrin e punonjësve edhe Investimet. Numri i punonjësve janë efekti i pagave por nuk duhet të harrojmë se të gjitha shërbimet bëhen me punonjës të bashkisë, nuk prokuromë as mirëmbajtje rruge, as shërbime publike etj, këto normalisht përkthehen në paga.

#### **Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:**

Dikur në bashkinë Fushë-Arrëz, pastrimi e gjelberimi i qytetit ishin privat, tenderoheshin. Në një moment të caktuar bashkia vendosi që t'i menaxhojë shërbimet me punonjës të bashkisë. Bashkia jonë nuk ka konstatuar problematikat reale të tërmetit të rënë në 2021 dhe kjo nuk na favorizon në investimet. Në respekt të ligjit kemi vendosur që në periudhën e zgjedhjeve të mos merret askush në punë dhe kështu disa punë dhe investime do të bëhen mbas datës 11 Maj se pse Fondi i Zhvillimit na ka dhënë materialet por punëtorët do i gjejmë vetë, pra jemi bashkëfinancues.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 3 e rendit të ditës:** Projektvendim për miratimin e propozimit për dhënie titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Fushë-Arrëz të Z. Ndoc Prendi.

Normalisht duhej të kishte një përfaqësues të "Lëvizja Vendlindja Amanet" që të referonte propozimin megjithatë po vazhdojmë ne. Lëvizja Vendlindja Amanet me datë 23.10.2024 ka bërë një kërkesë drejtuar kryetarit të bashkisë. Lexohet kërkesa për propozim; Projektvendimi dhe Relacioni.

Nga zyra e Sekretarit të Këshillit bazuar në ligjështë dërguar Autoritetit të dosjeve dhe Pastërtisë së figurës formulari i vetëdeklarimit të Z. Ndoc Prendi dhe gjithashtu eshtë kthyer edhe përgjigjja pozitive, ku ju e keni të gjithë në dosjet tuaja. Në këto kushte ne sot n'a hapet rruga për të proceduar në lidhje me dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Fushë-Arrëz, Z. Ndoc Prendi.

Ndoc Prendi eshtë i njohur nga të gjitha gjeneratat për faktin se ka qenë mësues në profesion, njihet për thjeshtësinë, ndershmërinë, komunikimin, urtësinë dhe kulturën e qytetëruar.

**Besjana Marku**, anëtar e këshillit:

Unë kam pasënderin t'a njoh Z. Ndoc Prendi, e kam pasë mësues dhe ka qenë edhe kryetar komune asokohe për Blerimin. Më vjen shumë mirë që i ka rënë ndërmend dikujt për t'a propozuar të nderuarin Ndoc Prendi për "Qytetar Nderi" i bashkisë Fushë-Arrëz dhe e falenderojmë me këtë rast "Lëvizjen Vendlindja Amanet" për propozimin.

Z. Ndoc Prendi në çdo rrethanë kur bëhej fjalë për të ndihmuar bashkëfshatarët e tij, ai kurre nuk ka thënë jo qoftë edhe nga ekonomia e tij personale. Edhe sot që eshtë në moshën 70 vjeç nëse bëhet fjalë për të dhënë ndihmën e tij për ndonjë emergjencë shëndetësore apo nevojë të banorëve eshtë i gatshëm në çdo moment për të dhënë kontributin e Tij.

Si mësues mbahet mend nga të gjithë si mësuesi mjeshtër dhe me arritje të larta. Unë si anëtar e Komisionit Këshillimor "Për dhënien e Dekoratave, Titujve të Nderit, Medaljeve ose Titujve vendor të Nderit" jam dakord për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i bashkisë Fushë-Arrëz, Z. Ndoc Prendi duke falenderuar edhe propozuesit.

**Valentin Doçi**, anëtar i këshillit:

Jam dakord për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i bashkisë Fushë-Arrëz, Z. Ndoc Prendi sepse ai eshtë i njohur nga komuniteti mbarë për vlerat e veçanta të tij.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Mua më vjen mirë që Besa e para si nxënëse e Ndocit dhe e dyta si bashkëfshatare rrëfen në mënyrë krejt të sinqertë për vlerat e Z. Ndoc Prendi. Kjo eshtë vlerë edhe për Besën njëkohësisht.

**Zef Cara**, anëtar i këshillit: Jemi absolutisht dakord.

**Franc Doda**, anëtar i këshillit:

Z. Ndoc Prendi është i njohur nga të gjithë ne si burri i urtë e me vlera të veçanta, ndaj jemi dakord për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i bashkisë Fushë-Arrëz duke respektuar në këtë mënyrë edhe propozuesit.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ne falenderojmë propozuesin Lëvizjen Vendlindja Amanet, bashkohem me të gjithë për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i bashkisë Fushë-Arrëz, Z. Ndoc Prendi. Njëkohësisht është nder për ne të vlerësojmë figura të tilla si Ndoc Prendi.

Meqenëse të gjithë këshilltarët që janë present shprehen dakord po e hedhim në votim.

- Miratohet propozimi për dhënie titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Fushë-Arrëz të Z. Ndoc Prendi **me:**

**11 vota pro            0 vota kundër            0 vota abstenum**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 4 e rendit të ditës:** Raport vjetor i veprimtarisë dhe vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

**Naze Selimaj**, Sekretar i Këshillit Bashkiak: (përbledhje e shkutër e Raportit, të detajuar e gjeni në faqen ëeb të bashkisë)

Të nderuar këshilltarë! Po bëj një përbledhje të koncentruar të Raportit vjetor të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, eficencë dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vetë këshilli.

Më poshtë po paraqesim disa nga aktivitetet e Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz për vitin 2024.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 39 (tridhjetë e nëntë) mbledhje komisionesh me pjesëmarrjen e 15 këshilltarëve. Numri më i madh i mbledhjeve të komisioneve është ai i komisioneve të përhershme me 34 (tridhjetë e katër) mbledhje dhe 5 mbledhje për komisionet e tjera të cilat janë ngritur për probleme të bllokimit të rrugëve dhe rendit të ujtit vaditës.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2024, janë marrë 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Fushë Arrëz, nga të cilat për 63 (gjashtëdhjetë e tre) vendime është shprehur pozitivisht për ligjshmërinë Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër dhe 3 (tre) janë kthyer për rishqyrtim.

Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë me ndihmën ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 % me rreth 18.2 %, pastaj vijnë vendimet në lidhje me buxhetin sipas fazave të programit buxhetor 2025-2027 me rreth 21.2 %.

Gjatë mbledhjeve të këshillit kanë marrë pjesë mesatarisht 12 këshilltarë. Mbledhjet frekuentoohen nga 80-100 % e këshilltarëve të shumtën e herëve.

Në Këshillin Bashkiak Fushë Arrëz për periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë regjistruar 11 (njëmbëdhjetë) kërkesa të gjitha të marra në konsideratë dhe trajtuar në Këshill Bashkiak. Pjesa më e madhe kërkesave ka qënë për hapje rrugësh, problematika me rendet e ujit vuditës etj.

Këshilli Bashkiak i ka kushtuar vëmendje të veçantë dëgjesave publike për projektatet për të cilat kërkonet nga ligji. Janë zhvilluar 9 dëgjesa publike për 4 projekta: Plani i Integritetit të Bashkisë për 2025-2027; Plani i mbarështimit të ekonomisë pyjore për Mzi dhe Iballë; Dhënia në përdorim e fondit kulloso/pyjor për kanalin e linjës së ujit puka në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz; Projektet e investimeve 2025-2027, Relacioni i PBA 2025-2027.

Në dëgjesa morën pjesë gjithsej 273 qytetarë, biznese, grupe interesit, anëtar këshilli etj, ku janë dhënë 107 rekomandime.

Gjatë vitit 2024 janë shpenzuar 310,000 mijë Lekë. Pjesa më e madhe e buxhetit është shpenzuar për mbajtjen e dëgjesave publike për projekta të ndryshme, shpenzime per trajnimin e këshilltarëve.

Duke ju falenderuar për vemandjen tuaj, dua t'ju përgëzoj për seriozitetin, punën dhe përkushtimin tuaj në shërbim të komunitetit.

Nuk ka diskutime lidhur me Raportin vjetor të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 5 e rendit të ditës:** Rishqyrtimi i vendimeve të kthyera nga Prefektura.

**Naze Selimaj**, Sekretar i Këshillit Bashkiak: *Po, kemi VKB nr. 4 të datës 27.01.2025 "për përcaktimin e çmimit të qirasë mesatare të njësive të banimit dhe apartamenteve në treg, përfshirë efekt të subvencionimit të qirasë në bashkinë Fushë-Arrëz për vitin 2025".*

Prefekti kërkon rishqyrtim të VKB nr. 4 të datës 27.01.2025, duke bërë plotësim të aktit edhe për zonat rurale në territorin e bashkisë Fushë-Arrëz, në respekt të parimit të gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit.

Zyra përkatëse është vënë në dijeni me një kopje të shprehjes së Prefektit, në momentin që do të jenë gati do të rishqyrtohet në mbledhje të Këshillit Bashkiak.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 6 e rendit të ditës:** Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve,

institucioneve, etj.

**Naze Selimaj**, Sekretar i Këshillit Bashkiak: Nuk kemi të depozituar asnjë kërkesë me shkrim nga qytetarë apo institucione.

**Pika numër 7 e rendit të ditës:** Të ndryshme.

**Franc Doda**, anëtar i këshillit: Një problem tejet shqetësues për qytetarët janë bërë qentë endacakë që lëvizin lirshëm nëpër qytet. Shumë të shqetësuar për fëmijët, pleqtë dhe të gjithë banorët.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Bashkohem ankesës së dalë tani pavarësisht se jam pro kafshëve por këtu bëhet fjalë se po vihet në rrezik jeta e njerëzve.

**Hil Curri**, Kryetar i bashkisë: Do të marrim masa për këtë, por ka dhe një problem se qytetarët po i ushqejnë vetë dhe po i mbajnë afër. Gjithsesi ne do të gjejmë forma për t'a zgjidhë këtë problematikë.

**Besjana Marku**, anëtare e këshillit: Problematikë janë bërë xhamat e shisheve të thyera pranë lokaleve që hidhen në shkallët ngjitur me çerdhen e femijëve. Fëmijët mund të rrezikojnë nëse kalojnë vetëm në ato shkallë.

**Valentin Doçi**, anëtar këshilli:

\* Pedonalja është shumë e amortizuar, sidomos qendra, a mund të gjendet një zgjidhje?

\*Të paktën korsia e makinës të shtrohet me asfalt dhe të hiqen ata gurë.

**Hil Curri**, Kryetar i bashkisë: Sa i përket pastrimit do të ndërhyjmë menjëherë, problem mbetet ajo ndërtesa në shembje, duhet të rrethohet me shirita, të bllokohen shkallët dhe të shpallet object rrezikshmërie, në mënyrë që të mos rrezikojmë jetën e njerëzve që kalojnë pranë asaj ndërtese. Hap pas hapi do të bëjmë të mundur shembjen e saj konform ligjt. Për momentin do të bëjmë një zgjidhje të përkohsme duke bllokuar shkallët në të dyja anët.

Pjesa e pedonales kuptohet që ka nevojë për ndërhyrje por e kemi të pamundur sepse eshtë një kohë shumë e shkurtër që është bërë shtrimi, ne vetëm mund të ndërhyjmë për riparim sepse ligjshmërisht nuk na lejohet.

**Hil Curri**, Kryetar i bashkisë: Jemi para faktit tejet shqetësues pwr qytetarwt, është rritur 3-fish çmimi i ujit të pijshëm dhe banorët po vijnë çdo ditë dhe po ankohen në bashki duke menduar se ujësjellësi menaxhohet nga bashkia. Në fakt punonjësit e ujësjellësit kanë vetën zyrat brenda ndërtesës së bashkisë ndërsa janë të varur nga drejtoria e Ujësjellësit Shkodër.

Qytetarët me të drejtë vijnë çdo ditë dhe ankohen për rritjen e çmimit të ujit, kështu që ne bashkarisht duhet të gjejmë një zgjidhje në mbrojtje të konsumatorit. Këshilli bashkë me administratën, me të gjithë banorët e bizneset që preken nga kjo rritje galopante e çmimit të ujit të mblidhemi të dalim me një peticion kundër rritjes së çmimit të ujit dhe t'ia dërgojmë Drejtorisë së Ndërmarrjes së Ujësjellësit Shkodër, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financës, Kryeministrisë, Avokatit të Popullit.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Rritja e çmimit të ujit është e papranueshme, kanë të drejtë banorët që ankohen. SHA që menaxhon ujësjellësin në Fushë-Arrëz nuk ka të drejtë të rrisë çmimin e ujit sepse nuk është njësoj si te ne dhe si në Shkodër.

Ne jemi pranë burimit, uji vjen në shtëpitë tona me rrjedhje të lirshme, pa asnje kosto, nuk ka nevojë për pompa apo ndonjë lloj mjeti tjetër. Nuk ka asnje arsyë për rritje të çmimit. Jemi të vetmit ne Fushë-Arrëzi që uji vjen në banesa pa asnje lloj kostoje.

Nëse jemi dakord të gjithë si Këshill t'a përcjellim shqetësimin tonë SHA-së, dhe nëse nuk do të ulen me ne të argumentojnë këtë rritje çmimi që në fakt nuk gjendet argument, siç një Këshill ka votuar për t'ia kaluar menaxhimin e ujit të bashkisë tonë kësaj SHA-je, ne si këshill do të detyrohem i t'a zhbëjmë me votë. Të gjithë banorët po vijnë çdo ditë në bashki dhe ankothen për këtë rritje paasnje lloj arsyë.

**Besjana Marku**, anëtare e këshillit: A ka një person të shkolluar, profesionist, punojës që shërben te ujësjellësi për të kontrolluar masën e hedhjes së klorit në ujin e pijshëm? Për ne sasia e madhe e klorit që i hidhet ujit është bërë shqetësim.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Ka një protokoll të hedhjes së klorit, punonjësit janë me përvojë në këtë drejtim.

Shqetësimet e banorëve janë të shtuara edhe me lidhjen e kontratave, ajo ka kapur shifrën 160 mijë lekë të vjetra dhe do të paguajnë edhe matësin që iu shet SHA-ja, praktikisht shuma shkon në 350 mijë lekë të vjetra.

Ndërsa përfshirat nuk kanë marrë përsipër me hapë asnje kanal apo shërbim lidhur me ujin e pijshëm, kemi pasë gjithë ato ankesa në dëgjesat publike lidhur me problematikat në ujin e pijshëm.

Kjo situatë nuk mund të vazhdojë më kështu, kjo është vjedhje e pastër. Duhet të gjejmë formë që t'a ndalojmë këtë zhvatje ndaj banorëve të bashkisë tonë.

Nëse jemi të gjithë dakord të ngrejmë një grup përfaqësimi nga Këshilli Bashkiak me tre anëtarë të kryesuar nga Kryetari i Bashkisë për një takim dypalësh me përfaqësues të Drejtorisë së shërbimeve Rajonale të Ujësjellësit Shkodër.

Atëherë nisur nga shqetësimet e gjithë komunitetit për problematikat që kanë me ujin e pijshëm dhe situatës së krijuar pas rritjes së çmimit dhe tarifave nga SHA e Ujësjellësit në Shkodër, **KB Fushë-Arrëz**, në mbledhjen e sotme, datë 28.02.2025, **propozon**:

Të ngrihet Grupi përfaqësues nga Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz që do të marrë pjesë në takimin dypalësh me përfaqësues nga SHA e Ujësjellësit në Shkodër me këtë përbërje:

1. **Hil Curri**, Kryetar i bashkisë
2. **Franc Doda** anëtar i KB njëkohësisht anëtar i Këshillit të Qarkut Shkodër
3. **Bardhok Qafa**, Zv/ kryetari i KB
4. **Besjana Marku**, anëtare e KB

E hedhim në votim ngritjen e grupit të përfaqësimit:

- Miratohet propozimi për ngritjen e Grupit përfaqësues nga Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz kryesuar nga kryetari i bashkisë që do të marrë pjesë në takimin dypalësh me përfaqësues nga SHA e Ujësjellësit në Shkodër **me**:

**11 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqë nuk kemi diçka tjeter për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur këtu.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen ju uroj suksese dhe mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

Besiana Morku

Bardhoku Dafa

VJOLLCA TABAKA

Terezë Demi Fejew

Valentin Dogi

KRYETAR  
Nikolin BARDHOKU

